



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranim / Dorezuar Prilbjen / Protobato Received / Delivery	08.11.2023	3	viti god. year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Zupenda	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK/6944/2023			1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1205/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1206/2023 të datës 25.09.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit Nr.22/2023 të datës 29.08.2023 të Divizionit të për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë: 07.11.2023 mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1205/2023 e datës 25.09.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi numër Nr.22/2023 i datës 29.08.2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenin 34 (2 dhe 3) dhe nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht më datë 11.07.2023 ka njoftuar lidhur me konkursin me numër reference Nr.RN00012041 për grupin „Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë“, për pozitën e punës „Inspektor Shëndetësor“ në Inspektoratin Shëndetësor/Ministria e Shëndetësisë, ku afati për aplikim ka qenë nga data 01.08.2023 deri më 09.08.2023.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi me kodin me numër Nr.RAN0016821. Më datë 21.08.2023 Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit ka

nxjerrë Vendimin me numër Nr.80/2023 përmes së cilit ankuesit i është refuzuar aplikacioni, me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi të kërkuar sipas Konkursit, së paku dy (2) vite përvoj pune (pas diplomimit) profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura, si dhe vërtetimin ku ka punuar me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Ankuesi kundër këtij Vendimi, më datë 23.08.2023 ka parashtruar ankesë përmes portalit elektronik në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa më datë 29.08.2023 Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.22/2023 përmes së cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.22/2023 të datës 29.08.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, më datë 25.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6239/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 05.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli më datë 09.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoli 1667 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 6239/2023 të datës 25.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.22/2023 të datës 29.08.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Referencën e datës 05.10.2023 të Spitalit të Përgjithshëm „Medecine Hospital-International”; Vërtetimin e datës 19.09.2023 të lëshuar nga Zyra e Personelit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; Aplikacionin i Kopje e letërnjoftimit me numër 322112; Certifikatën mbi dënimet penale me numër Nr.ser: D51FEBF1CD3E4CF e lëshuar më datën 23.09.2023 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Licencën e punës të datës 08.08.2019 të lëshuar nga Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës; Diplomën me numër Nr.100/19 të datës 12.04.2023 të lëshuar nga Kolegji i Shkencave Mjekësore „Rezonanca”; Mirënjohjen dhjetor 2020 të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë; Certifikatën dhjetor 2020 të lëshuar nga KEVP dhe OIK; Certifikatën e datës 05.05.2023 të lëshuar nga „Kongresi Kombëtar i Shkencave Mjekësore 11”; Pasqyra e Llogarisë së Trustit Pensional prej datës 01.08.2002 deri më datën 20.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 09.10.2023; Konkursin me numër reference Nr.RN00012041 të datës 01.08.2023; Vendimin me numër Nr.02/161 për emërimin e Komisionit të pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore i datës 25.09.2023; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; Njoftimin e datës 21.08.2023; Njoftimin e datës 29.08.2023; Vendimin me numër Nr.80/2023 të datës 21.08.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Ankesën e datës 23.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB; Aplikacionin me numër reference Nr.RN00012041 të datës 09.08.2023; Diplomën me numër Nr.253 e datës 10.06.2005 e të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Mjekësisë „

Dr. Anetaqim Deda , Certifikatën me numër 01/ Z-AJ142 00-01 maj, Certifikatën e datës 22.02.2020 të lëshuar nga Oda e Infermierëve të Kosovës dhe Kolegji-Heimerer; Certifikatën e datës 4-5 Maj

të lëshuar nga Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor; Certifikatën e datës 20-22 Prill 2018 të lëshuar nga „Konferenca Kombëtare e Shkencave Mjekësore V”; Certifikatën e datës 31 Mars-1 Prill të lëshuar nga AITA; Certifikatën e datës 29.01.2021 të lëshuar nga BM Sh.p.k; Certifikatën qershor 2017 të lëshuar nga Shoqata e Biokimistëve Klinik të Kosovës ; Certifikatën e datës 10.05.2017 të lëshuar nga Konferenca e 4-të e Shoqatës së Biokimistëve Klinik të Kosovës; Certifikatën e datës 25.09.2015 të lëshuar nga AtomMed-Medical Solution; Kontratë Pune e datës 16.04.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën me numër protokolli 6239/2023 të datës 25.09.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i njëjti nuk është pajtuar me arsyetimin e Vendimit me numër Nr.22/2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, pasi që përvoja e tij profesionale e kërkuar për pozitën e punës „Inspektor Shëndetësor” së paku dy (2) vite e tejkalon kërkesën minimale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit ka konstatuar se, kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me numër reference Nr. Referencë: RN00012041 për grupin „Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë respektivisht për pozitën „ Inspektor i Shëndetësisë”, klasa e pozitës „Profesionale 1” në Inspektoriatin Shëndetësorë/ Ministria e Shëndetësisë kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fushat; Mjekësi e Përgjithshme, Mjekësi tjetër dhe Menaxhim Mjekësore;*
- *Kualifikime të posaçme formale: licencë për ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*

Në pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin që dëshmon se diploma e marre jashtë vendimit është ne procedure te nostrifikimit; Kopjen e dëshmisë se punësimit te bashkangjitur se paku një dëshmi mbështetëse si ne vijin; pasqyrën pagesave te fondit te kursimeve pensionale ; kopjen e licencës për ushtrim te pavarur te veprimtarisë shëndetësore; Kopjet e dëshmisë se trajnimeve te ndjekura apo trajnimeve qe aplikuesi i ka realizuar ne cilësinë e trajnuesit; Dëshmi mjekësorë se kandidati është ne gjendje shëndetësore për te kryer detyrat; Certifikatën /vërtetimin nga Gjykata ose Këshilli Gjyqësore i Republikës se Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim te formës se prere për kryerjen e një vepre penale me dashje jo me te vjetër se gjashte (6) muaj nga data e lëshimit; Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e punës, është ne sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me të cilin dëshmohet se ai nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik; Nëse përvoja e punës e deklaruar është ne sektorin privat brenda apo jashtë vendit ne një OJQ brenda apo angazhimi nga i cili rrjedhe përvoja e punës ne ndonjë forme e marrëdhënies kontraktuale qe nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vete deklarim i nënshkruar se ajo nuk ka një mase disiplinore ne fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik te pushuar sipas ligjit NR.06/L për zyrtar Publik.*

Në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale për pranimin e zyrtarëve publikë të paraparë me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht me paragrafin 1, përcaktohet

se: *“Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”, ndërsa sipas nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurrimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion”.*

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, e që kanë të bëjnë me kërkesat e përgjithshme formale për pranimin në shërbim civil, Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të provave të lëndës konkretisht dokumentacionin që ka dorëzuar ankuesi me rastin e aplikimit, rrjedh se i njëjti nga muaji qershor 2010 deri në muajin shtator 2011 ka punuar në laboratorin Tirana Lab, nga data 01.10.2010 deri me date 31.03.2017 i njëjti ka punuar në laboratorin e Spitalit të Përgjithshëm Medicine Hospital Internacional në Prishtinë. Po ashtu ankuesi ka dorëzuar vetëm një faqe të Kontratës së Punës të datës 16.04.2019 përmes së cilës ankuesi është caktuar si U.D.Kryelaborant në Klinikën e Biokimisë Mjekësore, në Qendrën Klinike Universitare-QKUK mirëpo që kjo kontratë nuk ka faqe tjera nuk ka numër protokolli dhe po ashtu nuk ka nënshkrimet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi andaj Kolegji konstaton se meqë ankuesi e ka bashkëngjitur vetëm një faqe të kontratës ka qenë e pamundur për Kolegjin të vërtetoj përvojën e punës pas diplomimit gjegjësisht periudhën kohore se sa ka punuar ankuesi në këtë institucion, andaj pas konstatimit të këtyre fakteve, Kolegji vlerëson se ankuesi bazuar në dëshmitë të cilat i ka paraqitur me rastin e aplikimit nuk ka arritur të dëshmoj përvojën e punës prej dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës”, ashtu siç është kërkuar me konkurs. Po ashtu baze të dëshmive të ofruara ankuesi nuk ka ofruar vërtetim nga institucioni ku ka punuar apo një vete deklaram të nënshkruar nga ai me të cilin dëshmohet se ai nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi, me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka dorëzuar edhe dëshmi tjera për përvojën e punës, konkretisht Vërtetimin e datës 19.09.2023 të lëshuar nga Shefi i Sektorit të Personelit në Qendrën Klinike Universitare-QKUK përmes së cilit ka dëshmuar përvojën e punës por nuk ka dëshmuar se nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik. Kolegji po ashtu konstaton se të njëjtën dëshmi gjegjësisht Vërtetimin e datës 19.09.2023 të lëshuar nga Shefi i Sektorit të Personelit në Qendrën Klinike Universitare-QKUK ankuesi nuk e ka dorëzuar me rastin e aplikimit për emrin e grupit „Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë” respektivisht për pozitën „Inspektor i Shëndetësisë në Prishtinë” të shpallur sipas konkursit me numër reference: RN00012041 të datës 01.08.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme, ashtu siç

përcaktohet me dispozitat e nenit 12 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku ky fakt është vërtetuar edhe në bazë të dëshmime të ofruara nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa i njëjti Vërtetimin e datës 19.09.2023 me të cilin dëshmohet përvoja e punës së tij e ka bashkangjitur vetëm me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, bazuar në kriteret e konkursit po ashtu edhe dëshmitë e bashkangjitura nga ankuesi, në pajtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka bërë vlerësimin paraprak nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e konkursit, rrjedhimisht në bazë të kësaj ankuesi me Vendimin me numër Nr.80/2023 të datës 21.08.2023 është njoftuar që nuk ka plotësuar kushtet e konkursit me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi lidhur me përvojën e punës profesionale pas diplomimit prej dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës". Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, janë përcaktuar kriteret për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht pozita për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë, hyn në kategorinë e nivelit profesional 1, ku shtojca me numër Nr. 1/6 pika IV e kësaj rregulloreje tek kërkesat e përgjithshme formale- përvoja e punës theksohet se "*Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2(dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*", e në këtë rast meqenëse ankuesi, nuk ka ofruar dëshmi (vërtetim, kontrate te punës apo referencë) lidhur me përvojën e punës në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës siç kërkohet në konkurs por ka bashkangjitur vetëm një faqe të kontratës së punës, pa numër protokoll dhe po ashtu pa nënshkrimet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi atëherë sipas normave ligjore i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet e përcaktuara të konkursit, rrjedhimisht Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.80/2023 të datës 21.08.2023 për mos përfshirje në listën shkurtër të ankuesit ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me nenin 15 paragrafi 1, 2, dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: "*Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërliidhen me verifikimin paraprak..5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin*" ndërliidhur me nenin 34 paragrafi 6 nen paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe shtojcën me numër Nr. 1/6 pika IV, e të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Andaj mbi këtë mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit që i njëjti i ka plotësuar kushtet e konkursit sa i përket përvojës së punës është i pabazuar.

Nisur nga baza ligjore e përmendur si më lartë dhe nga vlerësimi i provave të lëndës, respektivisht dëshmitë e dërguar nga ankuesi me rastin e aplikimit, rrjedhë se ankuesi nuk ka përmbushur kriteret për të kaluar fazën e verifikimit paraprak ngase nuk ka dëshmuar me prova materiale dëshminë për përvojë të punës profesionale dhe nuk ka ofruar dëshmi- vërtetim nga institucioni ku ka punuar apo një vete deklarim të nënshkruar nga ai me të cilin dëshmohet se ai nuk ka një mase disiplinore në fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik të pushuar sipas

Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi me numër Nr.80/2023 i datës 21.08.2023 dhe Vendimi me numër Nr.22/2023 i datës 29.08.2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse i njëjti është nxjerr në frymën ligjore dhe mbi bazë të gjendjes faktike dhe duke u respektuar kompetenca dhe hierarkia ligjore e përcaktuar me nenin 34 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3, nenin 15 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe se i njëjti është i arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda më numër A.nr.1205/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.